

Zeqirja REXHEPI

**STRATEGJIA POLITIKE DHE DIPLOMATIKE E SKËNDERBEUT PËR
NJË KRYQËZATË KUNDËR SHTETIT OSMAN**

UDC 341.218.1(496.5:323.1=18)"1944"

Abstrakti: Në shekullin XV fuqia e Shtetit Osman ishte në rritje e sipër, përderisa Perandoria e “famshme” Bizantine funksiononte vetëm brenda mureve të Konstantinopojës. Dhe pikërisht kjo është koha kur Skënderbeu, i marrë peng si fëmijë, i shkolluar dhe i përgatitur në shkollat ushtarake osmane, do të kalojë nga kampi Osman në kampin Evropian.

I përgatitur në aspektin politik, ushtarak dhe diplomatik, Gjergj Kastrioti përmes sukseseve në fushëbeteja të luftës do të përpiqet të imponohet te Evropianët, si faktor kryesor për t’u vënë në krye të një organizimi ushtarak evropian që synohej të organizohet kundër Osmanëve. Duke e njohur mirë forcën ushtarake të Osmanëve, Gjergj Kastrioti përpiqej ta shfrytëzojë potencialin ushtarak evropian për të krijuar Shtetin Shqiptar, projekt i cili do të shndërrohet në kauzë kombëtare shqiptare për liri në shekujt e ardhshëm.

Gjergj Kastrioti nuk ishte vetëm një strateg i përkryer ushtarak, por ishte dhe një strateg politik dhe një diplomat i shquar. Ai tregoi aftësi të jashtëzakonshme mobilizuese të potencialeve njerëzore dhe materiale, si tek radhët e masave të gjera, ashtu dhe të elitës politike. Fjala e Gjergj Kastriotit, më 28 Nëntor 1443, se “Lirinë nuk e solla unë, por e gjeta këtu”, ishte një kushtrim mobilizues i masave popullore, ndërkaq në Kuvendin e Lezhës, më 2 Mars 1444, Ai i drejtohej elitës politike shqiptare të kohës, duke krijuar kështu vetëdijen e përbashkët arbërore shtetformuese për kauzën kombëtare.

Fjalët kyçe: Strategjia politike, kauza, diplomat, forca, projekt

Hyrje

Pas disfatës në betejën e Kosovës, më 28 qershor 1389¹, Ballkanasit u ndodhën në një kaos të plotë. Në këtë kohë kaosi dhe paniku, mbi gërmadhat e shteteve ballkanike ngrihej një fuqi e madhe aziatike duke e zëvendësuar Perandorinë e famshme Bizantine. Në këto rrethana ndodheshin edhe shqiptarët.

Në fillim shekullin XV-të, pothuajse të gjithë Ballkanasit e kishin “ulur kokën” dhe e kishin pranuar sundimin e Perandorisë Osmane. Bizanti ishte i rrethuar nga të gjitha anët me osmanët, dhe mund të merrte frymë vetëm brenda mureve të Konstantinopojës. Pikërisht në këtë kohë, kur zhvillohej akti i fundit të dramës ballkanike, pra ndarjes përfundimtare të Ballkanasve nga Evropa, në skenën historike shfaqet prijësi shqiptar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, i cili rebelohet kundër perandorisë më të fuqishme të kohës. Në të vërtetë rebelimi i Gjergj Kastriotit nuk ishte thjeshtë një kryengritje e zakonshme, duke kaluar nga kampi Osman në kampin Evropian, por rebelimi i prijësit shqiptar ishte shumë më tepër se kjo. Ai përfaqësonte një kauzë të madhe, që synonte shkëputjen nga Lindja.²Në

¹Ferdinand Schevill, *Ballkani – histori dhe qytetërim*, Tiranë, 2002, 157.

²Perandoria Osmane në shekullin XV përfaqësonte qytetërimin e Lindjes (Azinë).

këtë kohë, kauza e Gjergj Kastriotit mund të realizohej në aleancë me Perëndimin (Evropën). Një përpjekje e këtillë i vendosi themelet pro-evropiane për të gjithë Ballkanin dhe në veçanti për shqiptarët. Kjo kauzë do të bëhet aq e fortë në Ballkan sa që nuk mundi të ç'rrenjosej as nga sundimi pesëshkullor osman. Është fakt, se gjatë administrimit të pushtetit osman shumica e shqiptarëve konvertuan në islam, pra morën fenë e pushtuesit, por nuk e ndryshuan kurrë orientimin pro-evropian.

Pra, në themel të kauzës së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, qëndron KAUZA EVROPIANE, e cila nuk është ç'rrenjosur gjatë tërë kohës së sundimit të një perandorie të Lindjes, e cila përfaqësonte qytetërimin jo-evropian. Duhet pranuar se letërsia shqipe e kohës luajti rol tepër të rëndësishëm për të mbajtur gjallë ndër shekuj kauzën evropiane të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.

Përpjekjet diplomatike të Gjergj Kastriotit

Në kohën kur Perandoria Osmane i kishte shtrirë kufijtë e saj deri në Danub dhe në brigjet e Adriatikut, vojvodët e Hungarisë dhe Transilvanisë kryenin fushata ushtarake kundër Osmanëve. Fitoret e përmendura, në vitet 1442/43 kundër osmanëve e rikthyen vëmendjen tek qendrat e vendosjes evropiane, midis të cilëve Papët luanin rolin kryesor, në organizimin e fushatave. Një rol vendimtar në frymëzimin për luftëra antiosmane padyshim luanin papët e kohës. Kështu, Papa Eugjeni IV, në janar 1443 e shpalli zyrtarisht kryqëzatën. Gjatë këtij viti ushtriahungareze nën komandën e vojvodës Janosh Huniadi e kaloi Danubin dhe depërtoi thellë në brendi të Ballkanit, duke i mundur Osmanët afër Krushevcit, për t'udrejtuar drejt Nishit, në të cilin u zhvillua beteja më 3 nëntor 1443¹.

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, si një ushtarak, politikan dhe diplomat i regjur, akoma në shërbim të Sulltanit, me një vëmendje të madhe kishte kohë që e vrojtonte zhvillimin e ngjarjeve në Ballkan dhe rreth tij. Kur ushtria hungareze e Huniadi i drejtohet Nishit, Gjergj Kastrioti vjen në përfundim se, kishte ardhurçasti historik, për realizimin e idesë së madhe – kalimin nga Osmanët tek Evropianët, gjë që nënkuptonte krijimin e Mbretërisë së Kastriotëve (Mbretëria Shqiptare) dhe më pas fuqizimin e saj me ndihmën e fuqisë ushtarake të Evropianëve.

Për realizimin e suksesshëm të projektit të tij – Mbretërisë Shqiptare, Gjergj Kastriotit i duhej të tregojë gjithë shkathtësinë e tij politike, diplomatike dhe ushtarake. Pra, Ai njëkohësisht duhej të shpalos shkathtësitë politike për të krijuar Mbretërinë Shqiptare, shkathtësitë diplomatike për t'i akorduar politikat e jashtme të vendeve evropiane dhe shkathtësitë e tij ushtarake, të përballet në luftë kundër Osmanëve, me qëllim që të dëshmohej si udhëheqës i pashoq në Ballkan.

Me t'u kthyer në Arbëri, Skënderbeu si një strateg i madh politik iu përvesh punës për krijimin e një aleance me princërit shqiptarë, të cilët gjithashtu duhej të shkëputeshin nga Sulltani dhe të lidhen me të. Në këtë mënyrë, aleanca e princërve shqiptarë, pra me krijimin e një force të përbashkët do të mund të realizohej pjesa e parë e projektit ideor të Gjergj Kastriotit në mbrojtje të Mbretërisë Shqiptare. Për t'i bindur princërit shqiptarë të shkëputen nga Sulltani, Kastrioti e shfrytëzoi shkathtësinë e tij diplomatike, duke u premtuar princërve shqiptarë – aleatë, kryqëzatën, si mbështetje strategjike dhe veten e tij si kryekomandant të saj.²

Ndërkohë, përderisa Skënderbeu merrej me çështjen e organizimit të brendshëm, Huniadi pas Nishit ua merr Osmanëve edhe Sofjen. Gjatë dimrit të viteve 1443/44, Osmanët pësojnë disfata në Ballkan dhe në Azi të Vogël. Në këto rrethana Sulltan Murati II synonte të kërkojë paqe, duke bërë lëshime

¹Historia e popullit shqiptar I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, 397.

²Virgjl Kule, Kryqtari i Fundit, f. 42.

të konsiderueshme territoriale. Skënderbeu, përmes kanaleve të fshehtaishte në dijëni të planeve të Sulltanit. Paqja që mund të bënte Sulltani do të anulonte vazhdimin e kryqëzatës, për të cilën Skënderbeu aq shumë kishte shpresuar. Në këto rrethana, Skënderbeu përpiquej ta shfrytëzojë kohën që e kishte në dispozicion, pra dimrin e vitit 1443/44. Në këtë kohë ai duhej të mbajë Kuvendin me princërit shqiptarë për të marrë legjitimitetin, dhe për të krijuar forcën ushtarake shqiptare, e cila para se të lidhej paqja duhej të merrte pjesë në luftën e përbashkët të ushtrisë kryqëtare të Huniadit.

Akoma pa përfunduar stina e dimrit, më 2 Mars 1444,¹ në Lezhë, Skënderbeu thirri Kuvendin e princërve shqiptarë, që njihet në histori si Kuvendi i Lezhës. Princërit shqiptarë treguan gatishmëri për të bashkëpunuar, një fakt që dëshmon se ata e kishin kuptuar idenë dhe projektin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Siç është e njohur në Kuvendin e Lezhës u vendosën themelet e Mbretërisë Shqiptare, mbi parimin e *partneritetit*, ku Skënderbeu ishte “i pari mes të barabartëve”.²

Vlen të theksohet se, largimi i Skënderbeut nga Sulltani, kthimi i tij në Arbëri, pra kalimi në kampin evropian, erdhi si rezultat i parashikimit të heroit tonë se fitorja e *Evropianëve* (të krishterëve) ishte e pashmangshme. Si epilog, gjatë marrëveshjes së paqes fitimtarët do të ndanin plaçkën - territoret e çliruara nga Osmanët. Në këto rrethana, udhëheqësi i Mbretërisë Shqiptare – Skënderbeu, bënte plane që si aleat i *Evropianëve* të merrte pjesën që do t’i takonte.

Mirëpo, ngjarjet historike nuk u zhvilluan sipas planeve të Skënderbeut!

Një fakt tjetër që duhet përmendur është se, në shekullin XV, fuqia e Osmanëve nën udhëheqjen e Sulltan Muratit II dhe Mehmetit II, ishte në rritje e sipër, përderisa raportet midis shteteve të krishtera evropiane ishin plotë kundërtënie.

Disa muaj pas Kuvendit të Lezhës, përkatësisht më 12 qershor 1444 u nënshkrua Traktati i Paqes me Hungarinë, në Edrene. Paqja e Edrenesë do të përmbyste shpresat e Skënderbeut, sepse do të ndërpritej kryqëzata e filluar kundër turqve osmanë.

Sipas marrëveshjes hungarezo-osmane, në Edrene, u restaurua shteti serb në krye me Brankoviçin. Me krijimin e shtetit serb, Osmanët synonin të këputnin lidhjet midis Mbretërisë Shqiptare dhe Hungarisë, nga e cila fillonin fushatat e kryqëtarëve. Akoma pa u ratifikuar Traktati i Edrenesë, nga mbreti hungarez - Vlladislavi, Despoti serb, Brankoviçi shpejtoi të deklarojë zyrtarisht se nuk do të vazhdonte luftën me Ballkanasit tjerë kundër Osmanëve. Nuk kaloi shumë kohë, kur Brankoviçi bëri marrëveshje me Osmanët, të cilët i garantuan fronin në Serbi. Kjo donte të thotë se Skënderbeu dhe Mbretëria Shqiptare, e krijuar në Lezhë, do të duhej të përballlet e vetme kundër Perandorisë Osmane. Duke luftuar kundër një fuqie tejet të madhe, me fitore të njëpasnjëshme ushtarake, në rrafshin diplomatik, Skënderbeu i shfrytëzoi lidhjet diplomatike me Hungarinë, Papatin, Venedikun, Raguzën, Mbretërinë e Napolit. Në këto përpjekje, Skënderbeu nuk pati sukses për të nxitur aleanca për një kryqëzatë të re kundër Osmanëve. Tanimë, Ai ishte dëshmuar në shumë beteja kundër Osmanëve dhe në qoftë se do të organizohej kryqëzata e re, padyshim se do të vihej në krye të saj.

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu asnjëherë nuk e humbi shpresën për organizimin e kryqëzatës. Kjo nuk ndodhi as pas rënies së Konstantinopojës më 29 maj 1453, atëherë kur u trondit mbarë krishterimi. Gjeneraliteti i tij, i jashtëzakonshëm, qëndronte në faktin që rrethanat e pashpresa ti kthejë në rrethana optimiste. Kështu ndodhi edhe në kohën e rënies së Konstantinopojës, ngjarje të cilën e konsideroi si një moment për të rikthyer diçka të humbur, gjithnjë duke shpresuar në kthjellimin e Evropianëve të krishterë. Në këtë kohë, Ai nuk u dorëzua si shumë të tjerë, përkundrazi vazhdoi me përpjekjet diplomatike për organizimin e kryqëzatës.

¹Historia e popullit shqiptar I, 402.

²Virgjl Kule, *Kryqtari...*, f. 63.

Kah fundi i jetës së tij, pas fitoreve të tij kundër ushtrive osmane, gjatë vitit 1467, Gjergj Kastrioti do të përpiqet të fundit herë për organizimin e kryqëzatës, por kësaj radhe kjo përpjekje do të pengohet nga vdekja e heroit tonë, i cili në janar 1468 sëmuret dhe vdes.

Trajtimi i përpjekjeve diplomatike të Skënderbeut

Ajo që e bën të veçantë historinë e luftërave të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, kundër turqve osmanë, është padyshim kauza për të cilën hero i ynë vuri në sprovë tërë gjenialitetin e tij, si ushtarak, burrshtetas dhe njëkohësisht edhe diplomat i spikatur.

Kauza e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, në thelb ishte kauzë kombëtare shqiptare, për të ruajtur identitetin evropian të shqiptarëve. Kjo kauzë në shekullin XV ishte e kërcënuar nga pushtimet osmane dhe më pas administrimi i tyre.

Kauza evropiane e Skënderbeut, në të vërtetë përbën çështjen thelbësore, për të cilën edhe sot, disa historianë përpiqen t'i shtrembërojnë faktet historike, duke u përpjekur që luftërat e heroit tonë kombëtar, me përmasa mitike, t'i mohojnë ose t'i prezantojnë ato si luftëra të gabuara. Sipas tyre, luftërat e një populli të vogël kundër fuqisë më të madhe të kohës i shterën kapacitetet kombëtare të shqiptarëve.

Dilema që mund të shtrohet, si çështje debati, është fakti se a ishte i ndërgjegjshëm Gjergj Kastrioti për një ndërmarrje kaq të madhe përballë fuqisë më të madhe të kohës, aq më tepër kur ajo ndodhej në ngritje permanente, përpara të cilës ishin gjunjëzuar të gjithë popujt e Ballkanit?

Faktet historike dëshmojnë se ideja e Skënderbeut i tejkalonte përmasat e fuqisë së madhe të Osmanëve. Ndonëse, Ai synonte Mbretërinë Shqiptare në Ballkan, por kjo ishte pjesë e Evropës, gjë që nënkupton se megjithatë fuqia e përbashkët e *Evropianëve* e tejkalonte fuqinë e Osmanëve. Kur është fjala për kryqëzatën, Skënderbeu llogariste në pjesën më të madhe të shteteve evropiane të krishtera, të lidhura bashkë, përderisa Ai do të realizonte planet e tij.

Ideja e madhe e Skënderbeut – kauza shqiptare, si në shekullin XV, ashtu dhe më vonë, deri në kohën e sotme, ka mundur të mbështetej ekskluzivisht në Evropën e krishterë.

Humanisti shqiptar, Marin Barleti, në librin e tij *Historia e Skënderbeut*, largimin e Skënderbeut nga kampi osman e zbrit në rrafshin e personalizimit të çështjes, pra si një konflikt personal midis heroit tonë dhe Sulltan Muratit II dhe birit të tij, Mehmetit II Pushtuesit. Ndërkaq, nga ana tjetër, Barleti e lartëson Skënderbeun, duke e ngritur në hero të të krishterëve të kohës, i cili me fitoret e tij i pengoi Osmanët në vrullin e tyre drejt Perëndimit.¹Në të vërtetë, largimi i Skënderbeut nga kampi osman nuk kishte të bënte fare me ndonjë interes personal të tij, por kishte të bënte me kauzën e madhe, e cila mund të realizohej në çastin e dhënë historik. Skënderbeu me drejtë, fitoren e Huniadit dhe organizimin kryqëzatës antiosmane, e kishte vlerësuar si një çast vendimtar historik që ndoshta nuk do të përsëritet.

Për të fituar të drejtën për të marrë pjesë në ndarjen e territorit, pas humbjes së Osmanëve, Skënderbeu u largua nga Osmanët, organizoi Kuvendin e Lezhës, për të marrë verdiktin e princërve shqiptarë si udhëheqës i vetëm i Mbretërisë Shqiptare. Me këtë rast, Ai do të merrte pjesë në luftë si aleat i *Evropianëve* të krishterë, dhe në fund të fitores, në marrëveshjen e paqes, Skënderbeu do të mund të merrte pjesën që i takonte.

Nga ana tjetër, largimi i Skënderbeut nga Osmanët në kampin e të krishterëve, i ka futur në kurth shumë historioshkruer, duke e prezantuar këtë akt si “*tradhti*” apo si “*mbrojtës të krishterimit*”, pra si

¹Virgjl Kule, *Kryqtari*, 46.

mbrojtës i ngjyrimëve fetare. Në të vërtetë, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu sa ishte i krishterë po aq ishte dhe mysliman, po për të feja mbeti gjithnjë dytësore. Ai synonte ta shfrytëzojë forcën e shteteve të krishtera për të vënë në jetë projektin e tij madhor – Mbretërinë Shqiptare të Kastriotëve. Vlen të theksohet se, mbi këto parime bazë, më vonë Rilindësit i vendosën themelet e kombit shqiptar, si një rast i vetëm në Evropë, kur të krishterë e mysliman, ashtu siç ishte dhe vetë Skënderbeu, bashkërisht e krijuan Shqipërinë.

Përfundim

Mbretëria Shqiptare e Kastriotëve ishte projekt politik pro-evropian, një projekt për të cilin ishin angazhuar një numër i madh i princërve shqiptarë, si: Topiajt, Ballshajt, Muzakajt, Arianitët, që në kohën kur Osmanët ndodheshin në fillet e forcës së tyre.

Në shekullin XV, në kohën e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, fuqia ushtarake dhe politike e Osmanëve ishte rritur dukshëm më shumë. Megjithatë, ëndrra për Mbretërinë Shqiptare nuk ishte shuar. Skënderbeu e kishte plotësisht të qartë se jetësimi i projektit për Mbretërinë Shqiptare mund të realizohej në aleancë me shtetet e krishtera evropiane, duke e shfrytëzuar kështu fuqinë ushtarake të Evropianëve.

Edhe pse Mbretëria Shqiptare mbijetoi vetëm një çerek shekull, fama e heroit legjendar – Skënderbeut, luftërat dhe fitoret e tij mbetën të përvetshme në historinë kombëtare shqiptare, por edhe për Ballkanin dhe Evropën mbarë. Ndërkaq, fuqia e Osmanëve me kalimin e kohës, sistematikisht treq për t'u zhbërë tërësisht, me çka u zhbënë edhe territoret që ishin grabitur me forcën e armëve.

Lufta heroike e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut i bëri krenarë shqiptarët gjatë tërë kohës së sundimit osman, ashtu si edhe sot që na bën krenarë për identitetin tonë evropian, për më shumë arsye.

E para, kur në shekullin XV, zhvillohej akti i fundit i dramës ballkanike, pra ndarje nga Evropa, në skenën historike shfaqet prijësi shqiptar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, i cili rebelohet kundër fuqisë më të madhe të kohës. Rebelimi i Skënderbeut nuk ishte thjeshtë një kryengritje e zakonshme, por ishte një kauzë e madhe – kauzë evropiane, pra shkëputje nga një fuqi që përfaqësonte qytetërimin Lindor¹ dhe aleancë me Evropën që përfaqësonte qytetërimin Perëndimor.² Rebelimi i Gjergj Kastriotit ishte shpresa e vetme se kandili evropian në Ballkan nuk ishte shuar. Edhe përkundër administrimit osman, shpresa evropiane e Ballkanit do të vazhdojë përgjatë shekujve, deri në kohën tonë.

Bibliografia

Shqiptarët në Ballkan, Instituti Shqiptar për studime ndërkombëtare, Tiranë, 2001.

Barleti, Marin, *Historia e Skënderbeut*, Shkup, 2004.

Kule, Virgjil, *Kryqtari i fundit*,

Schevill, Ferdinand, *Ballkani – histori dhe qytetërim*, Tiranë, 2002.

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, *Bibliografi I*, Tiranë, 1997.

Jacques, E. Edwin, *Islamizimi i Shqipërisë nën Turqit*, Tiranë, 2019.

Rizaj, Skender, *Historia e përgjithshme (koha e re 1453-1789)*, Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Prishtinë, 1985.

Bartl, Peter, *Shqiptarët*, Tiranë, 1995.

Castellan, Georges, *Historia e Ballkanit*, Tiranë, 1996.

¹Qytetërimi Lindor në këtë kohë përfaqësohej nga Perandoria Osmane, myslimane.

²Qytetërimi Perëndimor – Evropa e krishterë.